REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2694/7 **Prot.** **Patos, më** 22/09/ **2026**

PROCESVERBALI I TAKIMIT 21 SHTATOR 2026

Temë: "Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027"

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak Patos

Ora: 11:30

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", VKB nr. 83, datë 17.12.2025 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027", si dhe njoftimit me nr. 2694/4 prot., datë 20.08.2026 me lëndë dëgjesë publike "Rishikim i ndryshimeve të projekt dokumentit të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit për vitin 2027".

Pjesëmarrës: ZV/ Kryetar i bashkisë Patos, znj. Ina Sauli, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Sekretare e Përgjithshme znj. Juela Shpata, Drejtor i Financave, znj. Mimoza Shtëmbari, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Çajup Refitaj.

29 Pjesëmarrës prej të cilëve:

- Banorë;
- Kryetarë të fshatrave;
- Përfaqësues nga bashkia Patos;
- Përfaqësues nga bizneset;
- Përfaqësues nga grupe të ndryshme interesi.

Takimin hapet nga Sekretar i Këshillit Bashkiak, znj. Refaela Xeba- Të nderuar të



Sekretar i Këshillit Bashkiak
znj. Refaela Xeba

Dëgjesë publike me temë:
Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-
2029 dhe buxhetit 2027

pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Qëllimi i kësaj dëgjese është rishikimi i kërkesave buxhetore për PBA 2027-2029 dhe buxhetit 2027. Ju ftoj të dëgjojmë prezantimin nga ana e ekzekutivit dhe më pas mund të drejtoni pyetjet dhe rekomandimet tuaja.

Drejtore e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari– Përshëndetje të gjithëve! Sot do të rishikojmë ndryshimet e dokumentit të buxhetit 2027, 2028, 2029 të cilat do të përballojnë shpenzimet në këto vite. Duke qenë se tarifat dhe taskat nuk ndryshojnë nuk kemi ndonjë të



Drejtore e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari

Dëgjesë publike me temë:

Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

ardhur shtesë. Ne sot jemi për ti rishikuar edhe njëherë kërkesat pasi jemi në fazën e buxhetit përfundimtar. Në këtë buxhet janë të pandryshuara me buxhetin që ne ju kemi prezantuar në fazën e parë. Kemi materializuar në këtë buxhet të gjitha kërkesat tuaja që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e rrugëve bujqësore, mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme, ndriçimin rrugor për aq sa ne mbulojmë në rrethin tonë të brendshëm. Kemi buxhetuar pjesën për mjedisin, mbjellje pemësh, shtim të koshave të mbeturinave dhe shtrirjen e këtij shërbimi dhe në zonat të pambuluara. Kemi buxhetuar sic thash edhe ndriçimin rrugor për ato linja të reja të cilat efektivisht nuk e kanë si shërbim ose dhe për njësimin e asaj linje të cilat kanë ardhur nga dëgjesat që kanë pasur problematika. Sot jemi në kushtet që ne të ardhurat nuk na ndryshojnë. Kemi po ato burime që kemi prezantuar dhe te buxheti i fazës së parë, të cilat nuk ndryshojnë dhe i ndarë në % është 43% shpenzimet e personelit, 35% janë shpenzimet për mirëmbajtjen për pastrim gjelbërimin, rrugët, ujitjen kullimin dhe të gjitha funksionet që ka bashkia dhe 22% janë buxhetuar për investime. Në vlerë absolute investimet janë 198 mln. 206 për 2028 dhe 206 po për 2029 dhe në këtë vlerë investimesh ne e kemi të krahasuar për 2025 dhe janë në rritje. Do vazhdojmë të minimizojmë shpenzimet korrente dhe të jenë në rritje të funksioneve dhe të komunitetit. Sot jemi për ti marrë edhe njëherë nëse ka kërkesa shtesë për vitin 2027.

Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

Kryetar i fshatit të Ri, z. Bexhet Rredhi- Kur bëhen çdo vit kërkesat kam ngritur një



Kryetar i fshatit të Ri
z. Bexhet Rredhi

Dëgjesë publike me temë:

Rishikim i ndryshimeve të PBA-së

2027-2029 dhe buxhetit 2027

problem që kur ka qënë Monda kryetare për një rrugë dhe a bëhet plani vit për vit që do shtrohet dhe nuk është shtruar, bëhet fjalë për rrugën Ferraj. Çakull i hedhin vit për vit e rregullojnë, por për të shtruar jo. E diskutova dhe vet me kryetarin dhe i thash dhe me tha po do ta shtrojmë. Por po them që po bëj që në kohën e Mondës dhe ky problem vazhdon. Ajo rrugë është e planifikuar, por nuk po shtrohet, ajo rrugë ka dalje komplet që dalin tokat bujqësore andej dhe po nuk u vendos një tumbino që do futet ujë matan në rrugë kryesore mbaron çdo gjë. Si do filloj rruga të shtrohet kur nuk është bërë kanali? Ata të vijnë nesër për të shtruar unë nuk i lë pa u bërë kanali.

Drejtore e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari– Ajo rrugë mesa di unë ka qënë përgjigje



Drejtore e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari

Dëgjesë publike me temë:

Rishikim i ndryshimeve të PBA-së

2027-2029 dhe buxhetit 2027

edhe nga kryetari në dëgjesat kur kemi qenë në Zharrëz, ne kemi lidhur marrëveshje dhe është në vazhdim të kontratës për asfalto betonin dhe është e parashikuar për tu shtruar me këtë kontratë, por që procedurat vijojnë dhe tani është lidhur kontrata.

Kryetar i fshatit Zharrëz, z. Abedin Hoxha- Aty është thënë që duhen kosha, kur do



Kryetar i fshatit Zharrëz
z. Abedin Hoxha

Dëgjesë publike me temë:

Rishikim i ndryshimeve të PBA-së

2027-2029 dhe buxhetit 2027

dorëzohen këto në fshat se kam dëgjuar që do vendosen kosha familjar? Si e keni parashikuar, kur do i jepni?

Drejtore e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari- Kemi përfunduar procedurën për vitin 2026 për kosht dhe në bazë të asaj që është kërkuar nuk di t'jua them me saktësi, por derisa po lidhet kontrata, ka përfunduar procesi i prokurimit, besoj se shumë shpejt do zgjidhet problemi i koshave. Po kështu kemi parashikuar dhe për vitin 2027 blerjen e koshave për grumbullimin e mbetjeve familjare.



Drejtore e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari

Dëgjesë publike me temë:

Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

Kryetar i fshatit Frashër, z. Irakli Zarka- Po për Frashërin do të ketë ndonjë investim? Rrugët e parcelave asnjë gjë nuk po bëhet.



Kryetar i fshatit Frashër
z. Irakli Zarka

Dëgjesë publike me temë:

Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

Kryetar i fshatit Siqecë, z. Myftar Sorraj- Dy rrugët Xhepaj dhe Hysaj janë pa filluar fare,



Kryetar i fshatit Siqecë
z. Myftar Sorraj

Dëgjesë publike me temë:

Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

kanë dy vjet. Hysaj është lënë përgjysëm është hedhur dhe çakulli. Traktori punoi pak muaj dhe ne kemi nevojë për rrugët e arave. Kemi rrugët e parcelave pa shtruar.

Përgjegjës, z. Donald Xhafa- Në Frashër është punuar te rruga e Përroit 100m, të kanali, sivjet nuk ka filluar akoma. Buldozeri në Siqecë do kthehet prap dhe do bëj pjesën tjetër që



Përgjegjës
z. Donald Xhafa

Dëgjesë publike me temë:

Rishikim i ndryshimeve të PBA-së

2027-2029 dhe buxhetit 2027

ka ngelur.

Zv/ Kryetare e bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- Për pjesën e rrugës Hysaj është planifikuar, kurse për rrugën Xhepaj është bërë aplikimi të FSZH-ja dhe presim përgjigje.



Zv/ Kryetare e bashkisë Patos
znj. Ina Sauli
Dëgjesë publike me temë:

Rishikim i ndryshimeve të PBA-së

2027-2029 dhe buxhetit 2027

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refacla Xeba